

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-Departamenti i përgjithshëm Divizioni Penal, përmes gjyqtares së vetme gjykuese Snezhana Mihajloviq, me sekretaren juridike Suzana Kovaçeviq, në lëndën penale kundër të pandehurit D.Sh. nga fshati ..., Komuna ..., për shkak të veprës penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të KPRK, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan PP.nr.2132/2017 të datës 29.11.2017, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor, me datën 14.02.2018, në prezencë të palëve publikisht shpalli

A K T G J Y K I M

I akuzuari D.Sh. nga babai B. dhe nëna H. (Sh.) , i lindur më data e lindjes..., në ..., jeton në fshatin ..., ka të kryer shkollën e mesme, i pamartuar, i punësuar në restorantin Bujana, i gjendjes së mesme ekonomike, deri më tani i pagjykuar, nuk zhvillohet procedurë për veprë tjetër penale, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

Ë S H T Ë F A J T O R

Me datë 11 nëntor 2017, rreth orës 23:30min., në fshatin ..., Komuna e ..., i pandehuri D.Sh., ka rrezikuar trafikun publik duke vënë në rrezik jetën e njerëzve dhe pasurinë e tyre, në atë mënyrë që duke drejtuar automjetin e markës ... me numër të regjistrimit ..., nga pakujdesia dhe në kundërshtim me dispozitat ligjore 41 dhe 73 të Ligjit për rregullat e trafikut rrugor, në bazë të së cilës në rrugë ose në ndonjë hapësirë tjetër të trafikut vozitësi synon të bëjë ndonjë veprim me mjet, lejohet të fillojë një veprim të tillë vetëm nëse më parë është i bindur se nuk i rrezikon ose nuk i pengon pjesëmarrësit e tjerë në trafik ose nuk e rrezikon pasurinë, kështu që i njëjti duke bërë tejkalim të pasigurte, me pjesën e përparme të anës së djathtë të automjetit të tij e godet në anësoren e përparme të anës së majtë, automjetin e markës “ ... ”, me numër të regjistrimit ..., të cilin e drejtonte E.J. i cili ishte duke u kthyer në të majtë të rrugës dhe si pasojë e kësaj nga lëshimet e lartpërmendura të të pandehurit, përveç dëmeve materiale në të dy automjetet, lëndime të lehta trupore pësojnë vet i pandehuri si dhe të dëmtuarit E.J. dhe B.M., të

cilët për shkak të natyrës së lëndimeve detyrohen të kërkojnë ndihmë mjekësore në Emërgjencën e Spitalit Regjional në Gjilan.

-me çka ka kryer veprën penale, Rrezikim i trafikut publik, nga neni 378 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 KPRK-së.

Andaj gjykata duke u bazuar në dispozitat e nenit 4, 7, 17, 23, 40, 41,42,46, 73 dhe 74, KPRK si dhe nenit 365, 451 dhe 463,KPP të pandehurit i shqipton

DËNIM ME GJOBË

I.Të pandehurit i shqiptohet dënimi me gjobë në shumë prej 200 (dyqind) Euro të cilën do ta paguaj në afat prej 15 ditëve të plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Nëse i pandehuri nuk e paguan dënimin me gjobë gjykata do të zëvendësojë dënimin me gjobë në dënim me burg, ashtu që një ditë burg do të llogaritet nga 20 euro.

II.Të dëmtuarit E.J. dhe B.M., për realizimin e kërkesës pronësore – juridike janë udhëzuar në kontestin civil.

IV. I akuzuari obligohet që në emër të paushallit të paguaj shumën prej 25 euro dhe shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të kësaj gjykate në afat prej 15 ditëve.

III.Në përputhje me nenin 39 paragrafin 3 nën paragrafi 3 pika 1 të Ligjit për kompensimin e viktimave të krimit, i pandehuri obligohet që në emër të taksave për kompensimin e viktimave të paguaj taksën prej 30 Euro.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti i përgjithshëm, ka ngritur aktakuzën PP.nr.2132/2017 të datës 29.11.2017, kundër të pandehurit D.Sh. nga fshati ..., Komuna ..., për shkak të veprës penale Rrezikim i trafikut publik, nga neni 378 par.6 lidhur me par.1 KPRK, dhe i ka propozuar gjykatës që i akuzuari të shpallet fajtor dhe të ndëshkohet sipas ligjit.

Në fillim të shqyrtimit të mbajtur me 14.02.2018 prokurori i shtetit Sllavica Popoviq ka deklaruar që i akuzuari ka pranuar veprën penale dhe atë e ka bërë në

mënyrë vullnetare dhe i ka propozuar gjykatës që ta shpall fajtor dhe t'i shqiptohet dënimi me ligj.

Të dëmtuarit E.J. dhe B.M., për realizimin e kërkesës pronësore – juridike janë udhëzuar në kontestin civil.

I akuzuari D.Sh ka pranuar fajësinë për veprën penale me të cilën ngarkohet, duke shtuar që më parë nuk ka qenë i gjykuar, që është i gjendjes së mesme ekonomike, që i vjen keq për fatkeqësinë e ndodhur, që në të ardhmen do të jetë më i kujdesshëm gjatë ngasjes, dhe që në të ardhmen nuk do të përsëris të njëjta ose tjera vepra penale, prandaj lut gjykatën që ta dënojë më lehtë.

Në shqyrtimin fillestar gjyqtarja individuale pas marrëveshjes së palëve merr vendim me të cilën e pranon pranimin e fajësisë, pasi që janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë. Në këtë aspekt gjyqtarja individuale ka konstatuar që i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, që pranimi është bërë në mënyrë vullnetare nga ana e të pandehurit që pranimi i fajësisë i përmban të gjitha faktet që përmban aktakuza. Aktakuza nuk përmban asnjë shkelje ligjore dhe gabime faktike.

Andaj, duke u thirrur në të dhënat e mëparshme, gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike: që i pandehuri D.Sh. ka kryer veprën penale me të cilën ngarkohet, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Në bazë të nenit 73 dhe 74 të KPRK-ës gjatë shqiptimit të dënimit kundër të pandehurit D.Sh. gjykata ka marrë parasysh të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit dhe si rrethanë lehtësuese ka marrë parasysh faktin që i pandehuri ka pranuar fajësinë, sjellja e tij korekte në gjykatë, që pendohet për veprën e kryer dhe premton që nuk do të kryej të njëjta ose tjera vepra penale.

Sipas besimit të gjykatës dënimi me kusht i shqiptuar ndaj të pandehurit Durim Shaqirit dhe duke pas parasysh rrethanat dhe të dhënat e mëparshme ky vendim është i drejtë dhe në përputhshmëri me peshën e veprës penale dhe shkallës së veprës penale të pandehurit.

Gjykata konstatoi që edhe me këtë dënim mund të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 41 të KPRK-ës, që të parandalohet kryesin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandalohet personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, të bëjë kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet

ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimi mbi shpenzimet për paushallin gjyqësor është bazuar në nenin 451 të KPP-së.

Nga të cekurat e mësipërme është vendosur si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
Departamenti i përgjithshëm

P.nr.1294/2017 me datë 14.02.2018

Sekretarja juridike,
Suzana Kovaçević

Gjyqtarja e vetme gjyqëse,
Snezhana Mihajloviq

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të njëjtit. Ankesa në dy kopje dorëzohet përmes kësaj gjykate.

Përktheu:
Ardijana Aliu